



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.11.2021, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i aktit normativ nr. 32, datë 5.11.2021 “Për miratimin e tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin e furnizimin nga dhe ndërmjet PFIZER EXPORT B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.01.2021 të Këshillit të Ministrave”.

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Klodiana Spahiu, Ilirian Pendavinji, Dasantila Tahiraj, Florenc Spaho, Shpresa Marnoj, Mirela Pitushi, Ilir Metaj, Tatjana Piro, Anila Denaj, Lindita Buxheli, Gertjan Deda, Petrit Vasili, Mesila Doda, Grida Duma, Orjola Pampuri, Zheni Gjergji, Ilda Dhori, Seladin Jakupllari dhe Antoneta Dhima.

Mungojnë:

Niko Kuri.

Të ftuar:

Eugena Tomini – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Antoneta Njehrrrena - Drejtore e Programimit të Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Në rendin e ditës kemi shqyrtimin e aktit normativ nr. 32, datë 5.11.2021 “Për miratimin e tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin e furnizimin nga dhe ndërmjet PFIZER EXPORT B.V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.01.2021 të Këshillit të Ministrave”.

Marrin pjesë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zëvendësministrja Eugena Tomini dhe Antoneta Njehrrrena, drejtore e programimit të standardizimit dhe harmonizimit të kuadrit rregullator në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Faleminderit!

Po ia kaloj fjalën përfaqësuesve të ministrisë, pastaj relatorëve dhe në fund do të kalojmë në diskutime.

Eugena Tomini – Faleminderit, zonja kryetare!

Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar deputetë.

Në kuadër të temës së sotme për sa i përket marrëveshjes me kompaninë Pfizer, së pari, po bëj një përmbledhje epidemiologjike të situatës në vend për COVID-19.

Prej më shumë se 18 javësh Shqipëria vazhdon me një situatë të qëndrueshme për sa u përket indikatorëve epidemiologjikë monitorues. Që në krye të herës së pandemisë, për sa i përket pozitivitetit në 24 orët e fundit, numrit të rasteve të hospitalizuar dhe numrit të rasteve që kanë kërkuar terapi intensive, për sa i përket situatës epidemiologjike, duhet të theksojmë sërish që incidenca dyjavore, si një indikator matës, gjatë gjithë periudhës, është një incidencë e qëndrueshme me luhatje ditore në varësi të hetimit epidemiologjik, si dhe në varësi të ndjekjes së kontakteve të rasteve primare. Ndërkohë, duhet të theksojmë se këto luhatje të kurbës epidemiologjike janë vërejtur ditë pas dite, përkundrejt testeve të kryera në bazë të survejancës së integruar laboratorike të laboratorëve publikë dhe jopublikë.

Për sa i përket shtrimit në spitale, aktualisht kemi 157 të shtuar me një kapacitet të nxëni në nivelin 57,3%. Ndërkohë, të gjithë e dimë se të dy spitalet CODIV 1 dhe COVID 3 janë si për

terapi intensive dhe jo intensive dhe klinika e personave apo pacientëve që janë të hospitalizuar shfaqin klinikë mbi të mesme.

Aktualisht, në terapi intensive janë 14 pacientë, që zënë 26,4% të nivelit të pacientëve të shtuar në terapi intensive. Duhet të theksoj se mbi 94 % e pacientëve, të cilët janë të hospitalizuar, janë të vaksinuar dhe një pjesë shumë e vogël e tyre, një përqindje shumë e vogël përkundrejt 6% të individëve që janë të vaksinuar, janë me 1 dhe 2 doza. Duhet të theksoj faktin tjetër se në këtë kuadër, niveli i mbulesës vaksinale i përlogaritur qoftë në nivelin kombëtar me 2,8 milionë banorë, por ndërkohë duke u vlerësuar edhe mbi popullatën target, që është +16 vjeç, varion në nivel kombëtar me një dozë 37,5%, ndërsa me dy doza në nivelin 32,8%. Për sa i përket popullatës target që është mbi +16 vjeç, ne kemi nivelin prej 46,9% me një dozë dhe 41,1% me dyja doza.

Në kuadër të kësaj situatë, në kuadër të zgjerimit të mbulesës vaksinale apo të aplikimet të vaksinave në fashën 12-15 vjeç me imunitet të komprometuar dhe imunitet të dobësuar, si dhe me sëmundje bashkëshoqëruese, në kuadër të vijueshmërisë së uljes së fashës për grup moshën 16-17 vjeç, për vijimin e vaksinimit mbi 18 vjeç të dozës *booster* dhe të dozës parësore bazale, vijmë në këtë takim sot për të paraqitur ndryshimet në nenin 2 të marrëveshje fillestare me Pfizer, ku ndërkohë në marrëveshjen fillestare ne kemi pasur një dakordësim për pikat nënkontraktuale, ku për çdo donacion të vendeve të Bashkimit Europian dhe jo vetëm, duhet të merrnim një dakordësi nga kompania Pfizer.

Aktualisht, kërkojmë miratimin tuaj, që të kemi një lehtësim të marrjes së donacioneve apo të rishitjeve, mbi dozat që mund të jepen kundrejt shtetit shqiptar në mbrojtje ndaj COVID-19, nga kompani Pfizer. Pra, ky lloj lehtësimi do të jetë dypalësh, jo vetëm nga vendet që japin donacion kundrejt Shqipërisë, vetëm duke njoftuar kompaninë Pfizer, por ndërkohë edhe vendet e tjera kundrejt kompanisë Pfizer, do të japin vetëm një njoftim që po japin donacion kundrejt shtetit shqiptar. Pra, ky është momenti i ndryshimit në nenin 2 të kontratës fillestare.

Faleminderit!

Albana Vokshi - Më falni, se nuk e kuptova, domethënë, kemi vetëm marrëveshjen e shtetit shqiptar me kompaninë Pfizer dhe vetë këto doza lejohen, këtë po thoni?

Eugena Tomini – Jo. Mund ta shpjegojë edhe zonja Antoneta, ndoshta nga ana ligjore më saktë.

Antoneta Njehrrrena – Përshëndetje!

Jo, ne kemi një kontratë me kompaninë Pfizer, që e kemi miratuar me aktin normativ. Për çdo ndryshim që do të bëhet në atë kontratë, ne duhet të vijmë këtu dhe të bëjmë një ndryshim të aktit normativ. Në kontratën aktuale ka vetëm një nen, i cili u referohet rasteve të dhurimit apo të rishitjes, që duhet të bëhet vetëm një njoftim në kompaninë Pfizer, dhe kompani Pfizer kërkonte që sa herë që ne kishim një dhurim nga çdo lloj shteti, që do të na dhuronte vaksina Pfizer, duhet të bënim ndryshim në marrëveshjen fillestare të Pfizerit dhe kjo do ta komplikonte situatën, se do të bëheshin ndryshim mbas ndryshimi për çdo lloj dhurimi. Ramë dakord që të shtojmë një paragraf, sikundër është shtuar paragrafi 2/9, i cili të bëjë rregullime të posaçme vetëm për dhurimet. Në rast se do të kemi një dhurim të dozave të vaksinave Pfizer, do të bëhet një njoftim në kompaninë Pfizer, nga të dyja palët edhe nga dhuruesi, edhe nga ne dhe ministria do të lidhë një kontratë me dhuruesit, në kushtet kur nuk kemi asnjë efekt financiar, sepse dhurimi është pa efekt financiar. Pra, është thjesht një rregullim, për të mos bërë ndryshime sa herë që do të kemi dhurime në marrëveshjen bazë të Pfizerit.

Tritan Shehu – E kuptoj këtë gjë, edhe hezitimin e Pfizer-it, sepse kjo mund të interpretohet si importe paralele dhe ky është problem. Megjithatë, në qoftë se Pfizer bëhet garant, mbasi ka marrë njoftim, unë nuk shikoj ndonjë gjë të keqe, përkundrazi, vetëm mendoj se Pfizeri duhet të vazhdojë të jetë garant për prodhimet e tij, pavarësisht nga rruga që ndjek, se në këtë rast merren nga të tretët, kjo është çështja dhe i vetmi problem që bie ndesh me parimin e sigurisë së medikamenteve.

Nëse Pfizer vetë si prodhues është dakord dhe bëhet vetë garant për artikullin, ne jemi dakord. Unë nuk shikoj ndonjë gjë të keqe, përkundrazi shikoj një mundësi për të qenë më fleksibël.

Vetëm një pyetje kam: kjo bëhet vetëm për vaksinat Pfizer apo mendohet edhe për vaksinat e tjera?

Antoneta Njehrrëna – Jo, vetëm për kontratën që kemi me kompaninë Pfizer.

Tritan Shehu – Unë nuk kam asnjë kundërshtim që kjo gjë të zgjerohet edhe për Astrazenecën, po të më pyesni mua, apo për Modernën. Unë do të thosha “jo” për vaksina që janë të pacertifikuara nga EMA, atëherë do të isha kategorikisht kundër, por për vaksina të certifikuar nga EMA me garancinë e prodhuesit, nuk shikoj asgjë të keqe personalisht.

Derisa merr përgjegjësi prodhuesi i certifikuar, për mua nuk ka asnjë problem.

Albana Vokshi - Domethënë, kush del garant për këto vaksina që vijnë nëpërmjet granteve të donatorëve të tjerë? Është ajo që sapo përmenda, kush del garant për cilësinë që nuk kanë kaluar afatet, skadencia e të tjera?

Antoneta Njehrrëna – Kompania Pfizer.

Në amendmin që ne kemi parashikuar është rënë dakord me kompaninë Pfizer.

Albana Vokshi – Pra, Pfizeri del garant.

Desantila Tahiraj - Shumë e rëndësishme në këtë që tha zëvendësministrja është edhe doza *booster*, që një pjesë e madhe e qytetarëve, të cilët janë vaksinuar me vaksina të tjera, certifikohen me green pass-in nëpërmjet kësaj doze. Kur mendohet që të fillojë aplikimi i kësaj doze?

Eugena Tomini – Faleminderit për pyetjen!

Aktualisht, që në datën 1 nëntor të vitit 2021, ka filluar zgjerimi i kalendarit të aplikimit të dozës *booster* dhe dozës parësore bazale, për të gjitha fashat e përmendura më sipër, pra mbi +18 vjeç, duke zbritur nga mosha më e lartë, siç kemi filluar me grupet e riskut në fillim apo në krye të herës të aplikimit të vaksinave në vend. Ndërkohë, e kemi zgjeruar vaksinimin edhe për fashat 12, 15, 16, 18 vjeç, sërish vetëm për Pfizer, aplikimin e kalendarit ndaj COVID-19 të fashat e mësipërme.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Seladin, fjala për ju si relator.

Seladin Jakupllari – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

E nderuar zonja zëvendësministre, ne ramë dakord për llojin e vaksinës, për sasinë e vaksinës dhe këtë e diskutuam edhe në seancë plenare dhe më vjen mirë që më në fund jemi të gjithë dakord për përdorimin e Pfizer-it si vaksina më e mirë që mendohet në këtë situatë pandemie. Gjithashtu, nisur edhe nga situata epidemiologjike aktuale që kemi me shtimin e rasteve, po ashtu edhe shtimi i rasteve kryesisht në Europë, se jemi në dijeni që janë shtuar rastet në Francë, në Gjermani, në Austri, në Itali, vaksinimi e bën të domosdoshme blerjen sa më shpejt të vaksinave dhe që doza *booster* të bëhet gati për popullatën.

Në lidhje me vaksinimin jemi shumë mbrapa, këtë dua të theksoj, domethënë, vaksinimi është shumë mbrapa te ne duke u krahasuar me Italinë që është 73%, Bashkimi European 76%,

Greqia 63%, Turqia 59%, Kroacia 46%, Kosova 42%, Serbia 45%, Mali i Zi 40%, kurse ne jemi në shifrat 33%, duke lëmë pas Bosnjë-Hercegovinën.

Pra, theksi duhej të vihej te shtimi i numrit të vaksinimeve. Kryesisht për studentët duhet bërë një promovim dhe të ngrihet një grup pune që të punojë më shumë me studentët, të cilët janë skeptikë në përdorimin e vaksinës. Shkencërisht ne duhet t'u mbushim mendjen të gjithëve që vaksina Pfizer është ajo që shpëton jetë, nisur edhe nga të dhënat tuaja statistikore që në pavijone më shumë të sëmurë kemi personat e pavaksinuar. Pra, edhe një herë unë dua t'i mëshoj faktit që vaksinën që do të marrim duhet të vendosim në përdorim sa më parë, me qëllim që ritmi i vaksinimit të vazhdojë me shifra sa më të mira dhe të mbrojmë popullsinë.

Faleminderit!

Tritan Shehu – Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja zëvendësministre,

Të jemi realistë, po të shikosh të dhënat, Shqipëria është në një gjendje shumë të rëndë. Numri i vdekjeve te ne, edhe ato që deklaroni ju, po t'i llogarisësh për 1 milion banorë, është më i larti në Europë. Bëni një llogari duke e llogaritur për 1 milion banorë. Shikoni sa e ka Italia numrin e vdekjeve për 1 milion banorë, që është një mesatare europiane, nuk po them Gjermania, dhe shikoni sa e kemi ne. Shikoni përqindjen e pozitivitetit të testeve, që te ne varion nga 20, 25 deri në 30%, kurse të tjerët e kanë nga 0,5-2%. Unë i konsideroj shumë shqetësuese këto elemente.

Ju folët për vaksinimin. Mund ta vendosim edhe më shumë, siç e ka dhënë *Metrics Institute* i Londrës, 36% me dy vaksina, kurse mesatarja botërore është gati 49%. Pra, jemi nën mesataren botërore, ku bën pjesë edhe Afrika, edhe Azia e prapambetur. Pra, me këtë nivel nuk siguron dot mbrojtjen. Italia po shkon në 90% të vaksinimit. Pra, nuk arrijmë dot të sigurojmë mbrojtjen e popullsisë. Për të mos thënë faktin që te ne një numër i madh vaksinash janë kineze. Vetë kinezët e dhanë 50,3%, kur foli drejtori i sëmundjeve infektive. Kurse Instituti i Gjermanisë e jep 30% efektivitetin e vaksinës kineze për variantin alfa, jo variantin delta.

Pra, unë mendoj që duhet të jemi të përgjegjshëm. INSTAT-i këto ditë tha që vdekje plus në Shqipëri në nëntëmujorin e parë janar-shtator janë 18% më shumë sesa në periudhën janar - shtator të vitit të kaluar, kur viti i kaluar është mbyllur me vdekje plus 12 mijë në Shqipëri, 9 mijë në nëntëmujor. Pra, i bie 10700 në nëntëmujor këtu. Po të vazhdojmë me këto shifra, në 2 vjet do të kemi 26500 vdekje plus. Këto nuk ndodhin as nga shtimi i traumave, as nga shtimi i numrit të sëmundjeve të zemrës, as nga shtimi i tumoreve, por një gjë e re ka ndodhur në këto vite, Covid-i.

Pra, jemi shumë larg shifrave që thoni ju zyrtarisht. Vdekjet plus dalin dhe ne nuk mund t'u shmangim, sepse në fund të fundit bëhet bilanci i vdekjeve plus. Sado të vendosësh si shkaqe të vdekjeve insuficiencën respiratore, tromboemboli pulmonare e të tjera, sëmundja bazë është Covid-i. Tani ka filluar që vdekjet të shkaktohen edhe nga pasojat e postCovid-it. Ne nuk kemi asnjë institucion të specializuar që të merret me pasojat postCovid, qoftë edhe ambulator, siç janë kudo, ku janë krijuar institucione polivalente ambulator.

Pra, unë mendoj që ka ardhur momenti që t'i shikojmë seriozisht këto gjëra. Komisioni European dhe FMN-ja thanë që ne jemi vendi i parë në Europë me numrin e humbjeve të jetëve për 1 milion banorë. Unë mendoj që ju si ministri duhet të jeni shumë seriozë këtu dhe duhet të keni një strategji të qartë. Duhet të na thoni qartësisht kur mendoni ju se do të arrihet që 85% e popullsisë të vaksinohet me dy doza? Në cilën datë e keni objektivin tuaj? Europa e mbyll këtë vit? Ju kur e mbyllni? Cila është perioda që ju mendoni se 85% e popullsisë shqiptare do t'i ketë marrë të dyja dozat e vaksinës?

E dyta, vaksinimi me dozën e tretë duhet bërë horizontalisht, siç po e bëjnë të tjerët. Nuk ka më zgjedhje. Kur kalojnë gjashtë muaj nga doza e dytë, duhet bërë doza e tretë. Edhe ... *(nuk dëgjohet)* atë tha. Ju e dëgjuat çfarë tha. Doza e tretë është horizontale. Këtu nuk ka më të zgjedhim rastet apo të mos zgjedhim rastet.

Së treti, uleni moshën në 12 vjeç, padyshim në bashkëpunim edhe me prindërit. Mosha do të shkojë në 5 vjeç, pavarësisht nga gjendja e fëmijëve. Horizontale edhe kjo. Të bëhemi gati për këto gjëra.

Çfarë do të bëhet me ata që kanë marrë vaksina të pasigurta, të pacertifikuara? Ju mund t'i besoni, por unë nuk i besoj. Nuk e di se në cilin laborator botëror e bazoni, por unë nuk i besoj laboratorit kinez, sigurisë që jep Kina. Dha shumë siguri për shumë gjëra dhe ja ku jemi. Unë u besoj atyre që thonë organizmat europianë, EMA-s dhe FDA-së. Unë pyes veten time: ku e gjejnë këtë kurajë këta që fusin vaksina të pacertifikuara nga EMA në Shqipëri? OBSH-ja nuk certifikon, ajo vetëm rekomandon në bazë të certifikimit që bën laboratorin nacional.

Zonja ministre përmendi në seancë çështjen e Hungarisë. Ndiqni strategjinë e Hungarisë, që i ka propozuar BE-së që dozën e tretë njerëzit që kanë marrë këto vaksina të pacertifikuara ta bëjnë me Pfizer. Jo dy doza, siç po e bën Turqia, por të paktën dozën e tretë, edhe pse akoma nuk është miratuar nga Brukseli.

Pra, duhet pasur një strategji se çfarë do të bëhet me këta njerëz. Do të bëhet doza e tretë me Pfizer? Do ta përsëritet i gjithë vaksinimi nga e para? Ju duhet t'i thoni publikisht këto gjëra, që njerëzit t'i kenë të qarta, sepse pastaj nuk ju besojnë më. Ne flasim, ju flisni, bëhet një kakofoni dhe njerëzit nuk vaksinohen fare. Që ata të vaksinohen, ju duhet t'i thoni qartësisht këto gjëra: do të veprojmë kështu me këtë, do të veprojmë kështu me këtë kategori, në këto data do të pranojmë këto lloj vaksinash.

Spitalet janë bosh, sepse njerëzit rrinë në shtëpi, nuk vijnë të shtrohen në Tiranë. Pse nuk hapni spitalet periferike? Kemi 2 vjet që jua themi këtë gjë. Njerëzit kanë vdekur në shtëpi, në majë të malit, sepse u krijua një psikozë negative në Tiranë. Ndoshta e gabuar, por u krijua. Njerëzit kanë nevojë të jenë atje ku kanë familjet, ku njohin infermierët, mjekun, sepse e ndjejnë veten më mirë.

Sa është përqindja e mortalitetit të të sëmurëve të intubuar në Shqipëri? Gati 100%. Pse? Çfarë nuk funksionon? Pse bota e ka 70% shërueshmërinë dhe 30% mortalitetin dhe 50% ka ECMO-n? Çfarë nuk funksionon këtu që gati 100% e të sëmurëve të intubuar kanë përfunduar keq? Unë e di çfarë nuk ka funksionuar, por ju takon juve ta nxirrni këtë gjë. Unë jam terrorizuar nga kjo gjë që po ndodh.

Prandaj, duhet të dilni me gjëra të qarta dhe ta lëmë propagandën: jemi këtu, duhet të bëjmë këtë, duhet të përmirësojmë këtë gjë, afate kohore, doza, sasi. Sa vakcina Pfizer do të vijnë në Shqipëri? Kur do ta mbyllni me këto vakcina vaksinimin e plotë? Të paktën të arrijmë në 85%, jo 90% të vaksinimit me dy doza të qytetarëve.

Keni bërë ndonjë studim zyrtar për imunizimin e popullsisë? Le që edhe asaj nuk i beson më njeri. Vaksinimi është horizontal, pavarësisht ka kaluar apo jo. Unë them që duhet të jemi shumë serioz në këto gjëra, sepse realisht po kalojmë situatë shumë të vështirë. Numri i vdekjeve plus është shumë i lartë.

Ka shumë gjëra për të folur, por meqenëse e hapët ju çështjen dhe nuk qëndruat vetëm te vakcina, unë ndërhyra. Po të kishit qëndruar vetëm te vakcina, do ta kishim mbyllur me aq, por meqenëse ju në fillim fare e hapët me një element propagandistik, më duhet të reagoj. Kështu si e gjykoj unë të paktën, edhe pse mund të jem gabim.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, zoti Shehu!

Po, Klodi.

Klodiana Spahiu – Faleminderit!

Besoj se e kam fjalën si relatore?

Albana Vokshi – Po.

Klodiana Spahiu - Ndryshimi që bëjmë sot në këtë akt normativ, ashtu siç u shpjegua edhe nga zëvendësministrja, është një amendim që vetëm lehtëson procedurën e alokimit të dozave, kryesisht të dozave që janë dhuratë. Besoj që ky ndryshim do t'i lehtësojë punën edhe ministrisë për të gjitha dozat e tjera të dhuruara, sepse përveç kontratës direkte me COVAX-in, një faktor i rëndësishëm është edhe dhurimi.

Në fakt, nuk e kisha menduar që do të dëgjonim përsëri të njëjtat fjali që i kemi dëgjuar në mënyrë të përsëritur dhe do të thosha që një nga faktorët që vaksinimi nuk ecën siç duhet janë sugjerimet e gabuara që ne japim shpeshherë.

Njerëzit duke dëgjuar të thuhet “vaksina të sigurta” dhe “vaksina të pasigurta” (ata që e thonë e kanë përgjegjësinë personale, sepse këtu i ndajmë përgjegjësitë me njëri-tjetrin), ne ndeshemi përballë një handikapi shumë të madh, i cili padyshim frenon qytetarët për t'u vaksinuar.

Bashkë me kryetaren e komisionit ne vendosëm që do të ishim nxitës, iniciues dhe bashkëpunues me universitetet për t'u bërë thirrje studentëve të vaksinohen. Të gjithë që jemi në tryezë, dikush nga ne ka pasur edhe funksione shumë të rëndësishme, e dimë shumë mirë që procesi i vaksinimit nuk do të jetë i detyruar. Në momentin që donim ta bënim të detyruar, e patë që u krijua një vështirësi shumë e madhe në përballjen me këtë gjë. Megjithatë, politika për momentin është e tillë dhe ka vende plot.

Austria që nga shkurti do ta bëjë të detyruar. Ne nuk duhet të dalim nga konteksti i ngjarjes që po jeton e gjithë Europa. Sot që ne flasim Gjermania po çon të sëmurë në Itali për t'u trajtuar në spital. Kur ne themi që jemi në një situatë shumë të rëndë, unë nuk dua kurrsesi të dezinformoj qytetarët që na ndjekin, e para duhet të kuptojmë që kjo fjali e thënë nga ne, nga Komisioni i Shëndetësisë, është shumë e rëndë, është vrastare, sepse ne e dimë shumë mirë që të dhënat zyrtare, ato që ne pranojmë, ato që janë dhe që janë në një farë mase të thëna nga mjekët dhe kolegët tanë, në spital sot janë 150 pacientë të shtruar.

Në qoftë se ne themi që kjo është situata sot, nuk ka kurrsesi arsye pse duhet të krijojmë panik dhe një situatë kaq të rëndë për qytetarët, kur dihet që ky është numri i rasteve. Po është pozitiviteti i lartë, ky është numri i rasteve që janë në spital, por të mos harrojmë që ky është numri i rasteve post Covid që janë shtruar në spitalet rajonale.

Unë ju garantoj, të nderuar kolegë, që po të merrni informacion nga spitalet rajonale në zonat që përfaqësoni, do të shikoni që në ta ka një numër të konsiderueshëm pacientësh që janë post Covid.

Komisionit tonë nuk i falet të thotë që jemi të dezinformuar, nuk janë shifra të sakta, nuk është përbindja kjo që thotë ministria. Ju mund të keni opsionin tuaj, por për një variant ne duhet të jemi bashkë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, mos më ndërprisni se nuk ia ndërpretë fjalën kolegëve që folën deri tani!

Ju lutem, mbani një standard! Jua kemi thënë në mënyrë të përsëritur këtë gjë.

Do të flas aq sa të më lejojë koha që kam në dispozicion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por nuk folën të tjerët për relacionin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë do të kërkoj me insistim që ne të jemi bashkë për një qëllim të përbashkët. Gjithashtu, u përmendën edhe shifrat e vaksinimit. Shifrat e vaksinimit janë këto që janë. Është detyrë kryesore e qeverisë të sigurojë dozat e vaksinës. Sot që flasim ka plot doza vaksinash rezervë që qytetarët të vaksinohen, por që të dramatizojmë situatën dhe të ndjellim panik kjo nuk shkon për këtë komision.

Padyshim, ju keni variantin tuaj. Ne do të vazhdojmë të punojmë fuqishëm për të mbështetur mbi të gjitha qytetarët për vaksinimin, për të rritur shkallën e vaksinimit.

Do të ishte në nderin e këtij komisioni që të krijonte agjendën për vizitat në universitete, për t'u bërë edhe një herë thirrje studentëve për t'u vaksinuar dhe për të bërë dozën e tretë. Në bazë të statistikave që vijnë nga spitali Covid 1 dhe Covid 3, kemi parë që 95% e rasteve që përfundojnë në gjendje të rëndë nuk janë vaksinuar. Nuk është e vërtetë që të gjithë qytetarët që shtrohen në spital vdesin. Do të ishte makabre që ne të dalim me këtë teori dhe t'u bëjmë thirrje qytetarëve të mos shkojnë në spital. Kjo është thirrja e gabuar që i detyron ata të qëndrojnë në shtëpi. Prandaj, ju lutem ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo të gjithë ata që shtrohen në reanimacion ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, doktor Tritani, por ju nuk duhet ta thoni këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Jam relatore dhe për projektligjin do të doja të fokusohesha në numrin e vaksinave Pfizer që kanë ardhur në Shqipëri.

Gjithashtu, kam edhe një kërkesë për Ministrinë e Shëndetësisë. Nëse është e mundur, meqenëse ka pasur protokolle nga vende të tjera që kanë bërë dy vaksinat e para kineze, më shumë për të pasur një siguri në green pass, të krijohet një mundësi që dozën e tretë ta bëjnë Pfizer ose Astra Zeneca në mënyrë që të kenë liri në lëvizje. Me çfarë kam dëgjuar, kemi arritur në pikën që kush ka kërkuar të bëjë Pfizer-in si dozë të tretë, e ka arritur këtë gjë në qendrën shëndetësore. Megjithatë, në qoftë se zëvendësministrja ka një informacion të shkurtër ose një variant të vetin për akuzat që u hodhën unë dua ta dëgjoj këtë përgjigje.

Albana Vokshi - Faleminderit!

Klodi, ne të tre të kryesisë, nëse vendosim të shkojmë në universitete, mund ta bëjmë bashkë si komision, mund ta bëjmë edhe individualisht, të ulemi të bëjmë një kalendar.

Po, Ilir.

Ilir Metaj – Kam një pyetje për zëvendësministren. Besoj se përqindja e të vaksinuarve në Shqipëri nxirret duke iu referuar popullsisë aktuale në Shqipëri që ka regjistruar INSTAT-i, që është rreth 2,8 milionë banorë. Sa është numri i shqiptarëve që jetojnë jashtë Shqipërisë nga këta 2,8 milionë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk besoj. 2,8 milionë janë shqiptarët e Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Që jetojnë në Shqipëri nuk e dimë të saktë, sepse ka shumë shqiptarë që për arsye pune apo emigrimi jetojnë jashtë territorit të Shqipërisë dhe nga këta janë një numër i madh që janë vaksinuar edhe jashtë territorit të Shqipërisë. Unë di shumë raste.

Kam idenë që përqindja e vaksinimit është shumë më e madhe nga sa është aty, duke iu referuar kësaj statistike. Kam një sondazh privat që kam bërë me disa njerëz, edhe pse mund të jem i gabuar, por nuk besoj.

Për sa u përket të tjerave, është mirë që ne si Komision Shëndetësie t'i lëmë gjeopolitikat me vaksinat, sepse politikat e vaksinave bëhen jashtë kësaj tryeze. Ne jemi këtu për të trajtuar vaksinën si qëllim prioritar, që është shpëtimi i jetës së njeriut.

Unë jam një nga ata që është vaksinuar me SINOVAC, pa asnjë lloj problemi dhe paragjykimi. Ndërkohë, vaksina SINOVAC shërben si green pass për shumë shtete në Europë, duke filluar nga Austria, Suedia, Finlanda, Holanda, Danimarka, të cilat e pranojnë vaksinën SINOVAC si green pass për të kaluar në vendet e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është e rëndësishme, sepse nëse nuk do të kishin besim nuk do ta linin dike të vaksinuar me SINOVAC të futej ne territorin e tyre. Ju nëse nuk keni besim te dikush që është i pa infektuar, nuk do ta pranoni në shtëpinë tuaj. Është e njëjta gjë, sepse është garanci.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos ndërprisni, sepse unë nuk ju unë ndërpreva edhe pse ju folët shumë më gjatë se unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, pra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kryetar, duam s' duam, disa gjëra që themi këtu, i dëgjojnë edhe njerëzit dhe krijojnë efekte pozitive apo negative.

Albana Vokshi – Ti vjen me sondazhe personale. Mos iu refero profesor Tritanit! Çdo deputet është i lirë të thotë atë që duhet të thotë.

Ilir Metaj – *Sinovac*-u shërben si *Green pass* në një pjesë të pjesë të madhe të vendeve europiane, pa diskutuar pastaj se në një shtet, si Singapori, që është me nivel jetese mbase më të lartën në botë dhe me nivelin e shërbimit shëndetësor mbase më të lartën në botë, e përdor *Sinovac*-un si një ndër tri vaksinat më efektive, *Moderna*, *Pfizer* dhe *Sinovac*.

E them këtë që të mos bëjmë politikë me vaksinat dhe të jemi këtu për një qëllim të përgjithshëm që është të vaksinohemi sa më shumë.

Albana Vokshi – Faleminderit!

Eugena Tomini – Faleminderit të gjithë pjesëmarrësve për komentet e adresuar kryesisht profesor Tritanit!

Absolutisht, diskutimi im nuk ishte propagandistik, por ishte për të treguar nivelin e situatës epidemiologjike dhe për të mos hyrë direkt në aktin normativ të parashtruar sot për ndryshime të përgjithësime për sa i përket COVID-19 dhe *Pfizer*.

Për sa i përket mbulesës vaksinale në Shqipëri, unë, jo pa qëllim, e përmenda, qoftë në nivelin e popullsisë target që është +16, qoftë në nivel kombëtar të popullsisë, ashtu siç deklarohet

edhe nga strukturat e tjera ndërkombëtare, në nivel kombëtar, në rastin konkret me dozë të parë është në nivelin 37,5% dhe në nivelin e gati 32,8% apo 33% me të dyja dozat.

47% dhe 41%, duke ndjekur të gjitha rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për sa i përket popullatës target, deri në fund të vitit i jemi përmbajtur në objektivin tonë për arritjen e gati 40% të popullatës shqiptare, sipas rekomandimeve, në pranverë në nivelin e 75% dhe deri në fund të dhjetorit 2021 në nivelin 40%.

Ndërkohë, këto rekomandime po përshpejtohen kundrejt planveprimit 2021-2023 që Ministria e Shëndetësisë, me të gjitha strukturat e tjera nën varësi, e ka të implementuar dhe është duke e ndjekur ndërkohë një plan veprimi komunikimi, duke filluar që nga nivelet e universiteteve, rektorateve për të qenë sa më pranë studentëve për të rritur mbulesën vaksinale edhe në fashën studentore +18.

Në lidhje me vdekshmërinë, pjesa e nivelit të vdekjeve dhe e të gjitha të dhënave të tjera jo vetëm për sa i përket numrit absolut të vdekjeve, por edhe përkundrejt gjithë indikatorëve të tjerë matës nga fillimi i pandemisë deri sot janë të dhëna të sakta, të marra nga të gjitha strukturat që vlerësojnë dhe monitorojnë të gjithë pacientët për sa i përket COVID-19.

Centralizimi i rasteve, të cilat trajtohen në spitalet COVID 1 dhe COVID 3, aktualisht, ka përvijuar gjatë gjithë fazës së pandemisë me periudha të zbatimit të planit aktiv, duke u kaluar shkallë pas shkalle, në varësi të kapaciteteve të ezauruara në nivel qendror në spitalet rajonale. Kjo është provuar edhe gjatë vitit 2020 në periudhën shtator-tetor- nëntor deri në periudhën e 2-3 muajve të parë të vitit 2021 për shkak të përshkallëzimit të planit kombëtar për decentralizim, pra për kalimin në planin aktiv sipas aktivizimit të spitaleve rajonale.

Për sa i përket vaksinës *Sinovac*, edhe është diskutuar shpesh për efektivitetin, sigurinë, cilësinë e saj, është një vaksinë e vendosur në listën e vaksinave për emergjencë nga OBSH-ja, e prekualifikuar, e miratuar edhe në SHBA për *Green Pass*-in për të gjithë udhëtarët që hyjnë në territorin e saj më shumë se sa tri javë. Ndërkohë, kolegu e tha, dhe nuk dua ta përsëris, se ka vende që e njohim si vaksinë të aplikueshme edhe për efektet e *Green pass*-it për popullatën që lëviz jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Theksoj se aktualisht është tejkaluar limiti i 1 milion vaksinave që kanë ardhur nga *Sinovac*-u për t'u aplikuar në Shqipëri. Aktualisht kemi mbi 1 milion vakcina *Pfizer* që janë aktualisht në Shqipëri për t'u aplikuar për popullatën shqiptare. Secila vaksinë e aplikuar apo e miratuar për të hyrë në Shqipëri në periudha të caktuara të pandemisë që nga 11 janari ka ardhur

me miratimin e Komitetit Teknik të Vaksinimit, i cili ka rekomanduar aplikimin e tyre në faza të ndryshme të pandemisë.

Sigurisht që dëshira dhe vullneti i mirë për të pasur vaksinat *Pfizer* është edhe takimi i sotëm për aktin normativ për të pasur sa më shumë mundësi, qoftë nga donacionet, por edhe nga kontraktimet e drejtpërdrejta të qeverisë për sa i përket vaksinës *Pfizer*.

Në lidhje me zbatimin e protokollit për sa i përket aplikimit të dy dozave, dozës parësore bazale dhe më pas dozës buster për personat që kanë aplikuar *Sinovac*, sërish në kuadër të Komitetit të Ekspertëve për imunizimin, kemi rekomandimet e tyre bazë, të cilat janë implementuar me një udhëzues specifik për të gjithë mjekët e familjes për të gjitha rastet dhe për të gjithë skemat e aplikuar në Shqipëri. Individët që kanë aplikuar *Sinovac*, mund të vijojnë me të aplikimet e vaksinave të tjera që janë të disponueshme, përveç kalendarit bazal, që do të thotë se, nëse ka vakcina *Sinovac* stok, sigurisht që do t'u aplikohet doza e tretë *Sinovac*.

Në rast se kemi aktualisht, sipas programit, për të gjitha vaksinat e disponueshme, pra nëse ne kemi 2 663 100 vakcina të ardhura në vend, janë aplikuar mbi 2 milionë e 49 mijë dhe aktualisht ka një stok, por me një plan shpërndarjeje në çdo pikë vaksinimi mbi 620 mijë doza vaksine, duke përfshirë të gjitha dozat e vaksinës së disponueshme në të gjithë zinxhirin ftohës në çdo qendër shëndetësore për të pasur alternativat nëse do të kemi *Pfizer*, *Sinovac*, *AstraZeneca* apo *Sputnik*. Zbatohet udhëzuesi i ndjekur hap pas hapi mbi kalendarin bazal, që është vaksinë *Sinovac*. Alternativa është çdo vaksinë e disponueshme për qytetarin, pra nëse do të kërkohet alternativa.

Në rastet kur kemi reaksione postvaksinale të raportuara kundrejt vaksinave *Sinovac* apo çfarëdolloj tjetër, sigurisht që ka alternativën për t'u rekomanduar për *Pfizer* apo *AstraZeneca*.

Ndërkohë, duhet të theksoj që çdo rekomandim i Komitetit të Ekspertëve është ndjekur hap pas hapi, është implementuar për çdo kategori vaksine, përkundrejt sigurisë dhe efektivitetit të përcaktuar nga industritë farmaceutike, por edhe nga vetë institucionet ndërkombëtare përgjegjëse për të aplikuar vakcina dhe për të miratuar për aplikim për cilëndo popullatë.

Në lidhje me doktoreshë Klodin, e cila përmendi rekomandimin mbi *Sinovac*-un dhe vendosjen e një doze të tretë vetëm *Pfizer* ose alternativa *AstraZeneca*, për të gjithë popullatën që ka aplikuar *Sputnik*, nuk do të aplikohet *AstraZeneca*, por do të aplikohet vakcina tjetër që mund të jetë *Pfizer* dhe, anasjelltas, për të gjithë ata që kanë aplikuar *AstaraZeneca* nuk do të bëhet aplikimi i dozës së tretë me *Sputnik*.

Nëse do të merret një rekomandim i tillë dhe do t'i kalohet Komitetit Teknik të Ekspertëve mbi rekomandimin e një doze të tretë vetëm *Pfizer* për popullatën që ka bërë *Sinovac*, sigurisht që do ta paraqesim pas reflektimit të rekomandimeve tuaja në Komitetin e Ekspertëve për Imunizimin.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Shehu!

Tritan Shehu – Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Unë do të them që nuk jam dakord me këto që thatë ju.

E para, ju thatë se ndjekim rekomandimet dhe agjendën e OBSH-së për nivelin e vaksinimit të popullsisë. E keni gabim. Duhet të ndiqni agjendën e Brukselit. Agjenda e OBSH-së është për Afrikën Qendrore, është një bllok shumë larg nesh. Ne duhet të krahasohemi me vendet europiane, pra agjenda jonë është europiane, e cila parashikon se brenda këtij viti duhet të arrihet 90% e vaksinimit të popullsisë me dy doza. Këtë duhet të synojmë ne.

Por ju, as me agjendën e OBSH-së nuk jeni, sepse ju e dini që mesatarja e vaksinimit të botës është sot 49%, sipas *Metric Institute of London*. Ju e dhatë tuajën rreth 30%, unë jua jap më shumë, 35% se kështu më del nga të dhënat e sotme të institutit britanik, pra ne jemi edhe nën mesataren botërore, ku hyjnë edhe Afrika, edhe Azia edhe vendet më të prapambetura të botës, me të cilat ne nuk ka pse të krahasohemi.

Pra, mua më duket se ju më traqetin tuaj keni gabuar. Objektivi juaj është objektivi i rekomandimeve të Brukselit. Ne jemi vend europian dhe këtu hyjnë edhe elementet të tjera.

Ju thoni se keni marrë vaksinat kineze që janë në 42 vende të botës. Jam dakord, por cilat vende janë? Afrika sa vende ka? Ne duhet të krahasohemi me vendet e Europës.

Ishit ju personalisht, në mos gabohem, ose Mira, por edhe Kryeministri i vendit, edhe Silva, që thatë se në Shqipëri do të vijnë vetëm vakcina të miratuara nga EMA. E thatë disa herë këtë gjë, e thatë me zë të lartë nëpër media; ma keni thënë mua në debatet e mia televizive: “Mos u shqetëso, zoti Shehu, se ne do të marrim vetëm vakcina të miratuara nga EMA”, ndërsa sot po na vijnë vakcina që nuk janë të miratuara as nga EMA, as nga FDA-ja, madje as nga Agjencia Britanike që është shumë serioze. Ne jemi vend europian dhe duhet të përmbushim standarde të Europës të sigurisë.

Shihni Kosovën! Pse është më mirë se ne në të gjitha nivelet, edhe të infektimit, edhe të vdekshmërisë? Pse Kosova nuk po përdor asnjë vaksinë të pamiruar nga EMA dhe ka nivel vaksinim më të lartë se ne? A është Kosova më e fuqishme se ne? Pse Kosova mban këtë politikë kaq konsekuente, kaq racionale dhe kaq vizionare, ndërkohë që kemi bërë një sallatë ruse vaksinash?

E kuptoni që na keni futur në një konfuzion total vaksinimi të popullsisë me ato vakcina të pamiruar që keni sjellë. Tani as vetë nuk e dini si do të dilni. Këto janë protokolle të rregullta, nuk ka “po pati këtë, e bëjmë këtë”. Kush ka bërë *Sinovac*, dozën e tretë do ta bëjë kështu, pikë. Mori fund kjo punë. Nuk diskutohet këtu “po pati, po nuk pati”.

Sinovac-u nuk duhet të vijojë as me dozën e tretë, as me të parën, as me të dytën. *Sinovac*-u duhet të hiqet krejtësisht nga qarkullimi. Unë ju thashë: hajdeni ta korrigjojmë këtë punë duke futur si dozë të tretë *Pfizer*-in, por duhet të futet në protokoll dhe të bëhet e detyrueshme.

Në fillim fare Hungaria bëri gabimin e parë dhe tani do të dalë nga gabimi në marrëveshje me BE-në, por BE-ja akoma nuk ia ka dhënë dritën e kuqe për këtë gjë. Po presin. Ishte për t’u dhënë javën e kaluar vendimi, por u shty edhe një javë. Pra, hajdeni të korrigjojmë gabimet, jo të thellohemi në gabime. Dozën e tretë *Sinovac*, thua ti, por kjo është papërgjegjshmëria më e lartë në botë. Jua them me bindje të plotë. Unë nuk do ta merrja kurrë guximin të bëja një sugjerim të tillë.

Hajdeni ta korrigjojmë dhe protokollojeni që doza e tretë e të gjitha vaksinave ruse dhe kineze të jetë *Pfizer*, sepse edhe për natyrën e tyre të teknologjisë së prodhimit shkojnë. Edhe amerikanët e rekomandojnë këtë gjë.

Papërgjegjshmëri dhe padije më e lartë se kjo nuk ka ku të shkojë. Jua them kështu. Më thuaj njëmijë komitete, po deshe, por po them ose profesionistët nuk janë gjëkund, ose komandohen nga të tjerët me çelës. Më vjen shumë keq që dëgjoj këtë fjalë që do të bëjnë *Sinovac* prapë.

Albana Vokshi – Kam përshtypjen se zëvendësministrja tha se do t’i përcjellim rekomandimet e Komitetit për Imunizimin. Pra, ne mund ta bëjmë një propozim, nëse biem dakord, që të merret parasysh nga Komiteti i Imunizimit që doza e tretë e të gjitha vaksinave ruse dhe kineze për të gjithë qytetarët të jetë *Pfizer*.

Çfarëdo të jetë e nevojshme, e diskutojmë dhe dërgojmë një shtesë të përbashkët për t’u marrë parasysh nga ekspertët e Komitetit të Imunizimit. Pra, e diskutojmë këtë gjë.

Për ta mbyllur, para se ta hedh në votim (nga statistikat duket që prapë jemi në fund, nuk është se kemi ecur shumë, për një arsye apo për një tjetër), theksoj se secili prej nesh, nga të gjitha palët, në të gjitha hapësirat që kemi pasur, edhe në seancat plenare, edhe ne kemi bërë thirrje për vaksinim, edhe ju keni bërë thirrje për vaksinim. U jemi bashkuar fushatave për rritjen e numrit të të vaksinuarve dhe do të vazhdojmë ta bëjmë, sepse besojmë se vakcina shpëton jetë.

Ndaj, edhe ne si komision i bashkohemi thirrjes për t'u vaksinuar. Do të bëjmë një plan me kryesinë e komisionit për të sensibilizuar edhe studentët, në mënyrë që të rritet përqindja e të vaksinuarve.

Sot Shqipëria e ka vetëm 33% numrin e të vaksinuarve me dy vakcina, Kosova e ka 10 pikë më shumë se ne, Mali i Zi e ka 8 pikë më shumë se ne. Nuk na pengon asgjë që t'i arrijmë vendet e rajonit dhe të ecim më përpara.

Prandaj edhe ne, të gjithë së bashku, me ministrinë dhe me akademinë mund të bëjmë më shumë në këtë drejtim duke shfrytëzuar edhe hapësirat e tjera që ne si deputetë kemi jo pak, edhe kur dalim në komunitet për të sensibilizuar qytetarët që të vaksinohen.

Ne jemi pro ndryshimit të marrëveshjes. Jemi pro, jo se kemi besim te qeveria, ta themi hapur, por kemi besim në këtë rast se garant është kompania *Pfizer*, ndaj edhe votat për këtë marrëveshje, si dhe për çdo marrëveshje tjetër, ku dalin garant institucione apo kompani të tilla si *Pfizer*, vota jonë do jetë pro. Është pro, sepse shpëton jetë. Është pro, sepse mbron shëndetin dhe jetën e qytetarëve. Pra, ne votojmë pro.

Urdhëroni!

Ilir Pendavinji – Dua të bëj një sugjerim për të mbështetur edhe atë që tha kryetarja e komisionit. Meqenëse do të marrim disa iniciativa ligjore, sensibilizuese për opinionin publik, mbase mund të na vihej në dispozicion nga ministria një tabelë me numrin e të ekzaminuarve me *Pfizer* me *Sinovac* apo me vaksinat e tjera, një tabelë me grupmoshat e caktuara që janë vaksinuar për të parë ku janë problemet. Duhet të shkojmë në 80% të vaksinuar. Si arrihet kjo? Hajdeni të marrim masa! Mbase duhet të bëhet sensibilizim nëpër televizione, mbase duhet të marrim disa iniciativa ligjore që televizionet të venë siglën: “Ju lutem, vaksinohuni!”, apo mediet *online*. Ne kemi detyrimin që mundet edhe mediet online, sa të hapim celularin të dalë: “Ju lutem, vaksinohuni!” dhe këto masa ne i kemi marrë herë pas here, kur na është dashur të sensibilizojmë opinionin publik për të ndërmarrë një veprim të caktuar.

Atëherë, hajdeni t'i marrim këto masa, por këto masa merren pasi të kemi disa tabela, të cilat i përmenda më sipër.

Duhet të marrim masa për të rritur sensibilitetin. Ne i kemi kaluar në kurriz, gjithsecili prej nesh e ka kaluar vetë apo në familjen e tij dhe e ka parë se sa e vështirë është për ta kaluar këtë virus.

Albana Vokshi – Urdhëroni, zoti Shehu!

Tritan Shehu – E rëndësishme është të dimë se si i parashikoni ju hapat e vaksinimit të popullsisë për të arritur minimalen, 85% me dy doza. Kur do të arrijë Shqipëria numrin e të vaksinuarve 85% me dy doza?

Albana Vokshi – Faleminderit!

Urdhëroni!

Seladin Jakupllari – Ne i mëshojmë shumë faktit të mbulesës vaksinale edhe për arsyen tjetër që të mos na dalë variant tjetër, prandaj duam sensibilizim.

Albana Vokshi – Faleminderit!

Nëse nuk ka diskutime të tjera, e hedhim në votim.

Kush është pro? Të gjithë pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 1?

Kush është pro? Të gjithë pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është pro? Të gjithë pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3.

Kush është pro? Të gjithë pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E votojmë në tërësi.

Kush është pro? Të gjithë pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në datën 2 dhjetor kjo marrëveshje kalon në seancë plenare.

Për kalendarin në vijim do të diskutojmë në kryesinë e komisionit që të bëjmë paraprakisht një draftkalendar që do t'ju paraqitet. Nëse keni propozime, ju lutem, na i dërgoni që t'i marrim parasysh!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA